



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot .

Patos, më 06/06/2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT: " Ndërtim mure mbajtëse në qytet dhe rrethina"**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Punë ndërtimore kod 45

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**6,870,056.87 (gjashtë milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e pesëdhjetë e gjashtë pikë tetdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH,** vënë në dispozicion nga të ardhurat lokale **2024** për objektin: **"Ndërtim mure mbajtëse në qytet dhe rrethina"**, vënë në dispozicion nga Të ardhurat Lokale 2024.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor Bashkia Patos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8,

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

**2.Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

---

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe nenit.

---

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **2,748,022.74 (dy milion e shtatëqind e dyzetë e tetë mijë e njëzetë e dy pikë shtatëdhjetë e katër) lekë**.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

**Fondi Limit: 11,666,406 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e gjashtë pikë dy) lekë pa TVSH**

**$6,870,056.87 \times 40\% = 2,748,022.74$  lekë vlera e xhiros se kerkuar.**

---

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se

operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022,2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar.

**2.2.3.** Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, kudo ku operatori ushtron aktivitetet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).*

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësitë e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kesteve, prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

**2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë si dhe dokumentat e mëposhtëm:

- i. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. *Situacion përfundimtar të objektit,*
- iii. *Aktin e Kolaudimit të objektit,*
- iv. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës nr.9*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve si dhe dokumentat e mëposhtëm:

- i. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. *Situacion përfundimtar të objektit,*
- iii. *Aktin e Kolaudimit të objektit,*

*(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

**6,870,056.87 x 30% = 2,061,017.06**

Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise, ne baze te VKM Nr 42 dt 16.01.2008 i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. **NP-1:** Punime germimi ne toke "Kategoria A".
- b. **NP-2:** Ndërtime civile e industriale "Kategoria A".
- c. **NP-5:** Punime nëntokësore, ura e vepra arti "Kategoria A".

Ne rast bashkimi operatoresh secili duhet te disponoje kategorite e licences sipas marreveshjes se bashkepunimit.

- **NP-1: Punime germimi ne toke** "Kategoria A"

*Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.*

- **NP-2: Ndërtime civile e industriale** "Kategoria A"

*Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.*

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazërma ushtrie, teatro, stadiume, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroportit me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.*

- **NP-5: Punime nëntokësore, ura e vepra arti** "Kategoria A".

*Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.*

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategori	Përshkrimi i	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv,	Niveli i	Vlera e
----------	--------------	--	----------	---------

a e kërkuar	kategorisë sipas legjislacionit të fushës	që përfshihen në kategorinë përkatëse		klasifikimi i kërkuar për kategorinë e respektive	punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime germimi ne toke	2.1	Germim dheu me krahe e transport me k dore 10 m, kategoria III.	Kategoria A	0-20 milion lekë
2.26a	Germim dheu themele e plinta b~2m, ekskavator me goma, kova 0.25m <sup>3</sup> shkarkim auto				
3.25/b	Germim me krahe seksion detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e zak.				
An-9	Mbushje me zhavorr pas mureve.				
3.164/1b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri.				
3.396	Mbushje me cakell pas mureve.				
2.258	Nenshtrese zhavori				
NP-2	Ndërtime civile e industriale	3.212/c	Shtrese stabilizant t=10cm	Kategoria A	0-20 milion lekë
2.262/3	Shtrese betoni C 12/15 per kunete				
2.282	Shtrese derrasa FM 4.0cm				
3.243	Struktura monolite betoni C 16/20				
2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6- 10 mm				
2.166/1a	F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm				
3.183	Guardrail - N2 anesore me 2 valez. ne 1 ane , E2 + aksesor				
2.116	Trare themeli b/a C16/20monolit				
3.406	F.V tub drenazhi Ø 150 mm				
2.116	Trare themeli b/a C16/20 monolit				
2.121	Brez b/a monolit C 16/20				
3.244	Struktura monolite betoni C 20/25				

NP-5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	3.331	Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1 m	Kategoria A	0-20 milion lekë
		3.340	Gabiona me rrjete teli te zing, gure kave 1x2x1.5m		
		3.333	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x2 m		
		3.335	Gabiona me rrjete teli te zing, gure kave 1x1x0.25m (shkalla)		
		2.54/2	Mur guri ne lartesi deri 3m me llaç çimento M 25		

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne baze te VKM-se Nr. 42 dt 16.01.2008 i ndryshuar.

*(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).*

**2.3.3.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- |   |         |
|---|---------|
| a. Inxhinier ndertimi                     | 1 (një) |
| b. Inxhinier gjeodet/topograf/markshajder | 1 (një) |

Per kete duhet te paraqes

- Diplome,
- CV,
- Kontrate pune te vlefshme,
- Të figuroj ne listpagesen e shoqërisë ne fazen e ofertimit Operatori ekonomik ploteson formularin permbledhes te vetedeklarimit,

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**2.3.4.** Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- a. Teknike ndertimi 1 (një)** per kete duhet te paraqes Diplome te shkolles se mesme, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesën e shoqërisë nga muaji Prill 2024 e në

vazhdim.

- b. Karpentier 2 (dy)** për këtë duhet të paraqes kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Prill 2024 e në vazhdim.
- c. Hekurkthyes 3 (tre)** per kete duhet te paraqes kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Prill 2024 e në vazhdim.
- d. Murator 2 (dy)** per kete duhet te paraqes kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Prill 2024 e në vazhdim.
- e. Shoferë 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, leje drejtimi dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Prill 2024 e në vazhdim. (Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).
- f. Manovratore 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, leje drejtimi, Dëshmi Aftësie Profesionale për Përdoruesit e Makinerive të Rënda, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Prill 2024 e në vazhdim.  
(Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).
- g. Puntore te thjeshte 5 (pesë)** per kete duhet te paraqes kontrate pune te vlefshme dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Prill 2024 e në vazhdim.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplome ose deshmi kualifikimi
- Kontrata pune,
- Ne raste kur makinerite disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar.

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- **Inxhinieri i Ndertimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve për ndërtimin e objektit, zbrërthimin e projektit konstruktiv. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve si psh të betonit, hekurit etj.
- **Inxhinier Gjeodet** eshte pergjegjes per zbatimin e sakte te punimeve te objektit qe prokurohet per secilin nga zerat e punimeve te ndertimit pjese e fushes se tij, zbatimin e projektit sipas të gjithë elementëve përkatës topografik.
- **Teknike ndertimi** (ose ing ndertimi ne zbatim) është përgjegjës për ndjekjen dhe ecurinë e punimeve ne kantierin e ndertimit.



- **Karpentiere** është përgjegjës për mbërthimin e saktë të kallëpëve, për realizimin e betonimit të elementëve të ndryshëm në objekt.
- **Hekurkthyesi** është përgjegjës për lidhjen e saktë të hekurit sipas skicave përkatëse të projektit konstruktiv.
- **Muratori** është përgjegjës për realizimin e saktë të punimeve të muraturës me materialet dhe detajet e specifikuar në projekt.
- **Shofere** janë personat përgjegjës për drejtimin e makinerive në kantiar dhe jashtë kantierit për furnizimin dhe transportin e materialeve të nevojshme për objektin që prokurohet. Në raste kur makinerit disponohen me qera, këta punonjes do të jenë të kontraktuar.
- **Manovratore** janë personat përgjegjës për drejtimin e makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit në kantiar dhe jashtë kantierit për kryerjen e proceseve të caktuara të punëve ( psh. presa/pompa betoni, ekskavatore gërmimi, mini fadroma, skrep të llojeve të ndryshme etj) të nevojshme për objektin që prokurohet. Në raste kur makinerit disponohen me qera, këta punonjes do të jenë të kontraktuar.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

### **Argumentimi:**

*Mbi punimet e ndërtimit të murit me gabiona në Dukas Breg:*

Janë në total rreth 150 m<sup>3</sup> mur me gabiona (Përfshirë punime gërmimi, mbushje me zhavorr pas mureve, montim guardrail etj). Norma për njësi është 7.07 ore/m<sup>3</sup>. Për realizimin e murit në total nevojiten rreth 1061.2 orë, punë e konvertuar në ditë 8 orareshe = 132 ditë pune. Koha e lene në dispozicion për procesin e realizimit të murit është 18 ditë pune. Shumfishimi i puntorisë është 7.3 here. Kërkohen 3 specialiste + 4 puntore.

*Mbi punimet e ndërtimit të murit mbajtës b/a Zona 1, Rruga “Dhori Tanaka”:*

Janë në total rreth 33.60 m<sup>3</sup> mur b/a (Përfshirë punime gërmimi, mbushje me cakëll pas mureve, etj). Norma për njësi është 30 ore/m<sup>3</sup>. Për realizimin e murit në total nevojiten rreth 1005 orë, punë e konvertuar në ditë 8 orareshe = 125 ditë pune. Koha e lene në dispozicion për procesin e realizimit të murit është 12 ditë pune. Shumfishimi i puntorisë është 10.4 here. Kërkohen 5 specialiste + 5 puntore

*Mbi punimet e ndërtimit të murit gurit Zona 2, Rruga “Dhori Tanaka”:*

Janë në total rreth 28 m<sup>3</sup> mur guri (Përfshirë punime gërmimi, mbushje me zhavorr pas mureve, F.V tubo drenazhi etj). Norma për njësi është 31.1 ore/m<sup>3</sup>. Për realizimin e murit në total nevojiten rreth 672.15 orë, punë e konvertuar në ditë 8 orareshe = 84 ditë pune. Koha e lene në

dispozicion per procesin e realizimit të murit është 12 dite pune. Shumfishimi i puntorise eshte 7 here. Kerkohen 4 specialiste + 3 puntore.

*Mbi punimet e ndërtimit të murit mbajtës b/a, Rruga “Banaj”:*

Janë në total rreth 80.11 m<sup>3</sup> mur b/a (Përfshirë punime gërmimi, mbushje me cakëll pas mureve, nënshtresë zhavorri etj). Norma për njësi është 18.70 ore/m<sup>3</sup> me. Për realizimin e murit në total nevojiten rreth 1500 orë, punë e konvertuar ne dite 8 orareshe = 187 dite pune. Koha e lene ne dispozicion per procesin e realizimit të murit është 18 dite pune. Shumfishimi i puntorise eshte 10.4 here. Kërkohen 5 specialiste + 5 puntore.

*Mbi punimet e ndërtimit të murit mbajtës b/a, Rruga “Rrapi Tiku”, Dukas:*

Janë në total rreth 13.8 m<sup>3</sup> mur b/a (Përfshirë punime gërmimi, mbushje me cakëll pas mureve, nënshtresë zhavorri etj). Norma për njësi është 28.47 ore/m<sup>3</sup>. Për realizimin e murit në total nevojiten rreth 393 orë, punë e konvertuar ne dite 8 orareshe = 49 dite pune. Koha e lene ne dispozicion per procesin e realizimit të murit është 6 dite pune. Shumfishimi i puntorise eshte 8.1 here. Kërkohen 4 specialiste + 4 puntore.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës.

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

*Argumentimi:* Mbeshtetur në klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" sipas se ciles shoqeria merr masa paraprake për të organizuar dhënien e ndihmës së parë nepermjet nje eksperti i cili do te jete i gatshem ne sistemin e ndihmes se pare duke pasur njohuri te pergjithshme mbi patologjite ne mjediset e punes.

**2.3.5.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 19 (nëntëdhëmbëdhjetë) persona në total.**

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentat për të vërtetuar këtë kriter janë:

- a) *Vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve te Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te rrethit perkates ose me vule elektronike .*
- b) *Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 25)*

*Shënim:* Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Referuar kategorise se punimeve si dhe afatit, stafi i kerkuar duhet te jete:**

- **Drejtues teknik** 2 (dy)
- **Karpentiere** 2 (dy)
- **Hekurkthyes** 3 (tre)
- **Murator** 2 (dy)
- **Puntore te thjeshte** 5 (pesë)
- **Shofere** 2 (dy)
- **Manovratore** 2 (dy)
- **Tenknik Ndërtimi** 1 (një)

**TOTALI = 19 Persona ne Staf (nëntëmbëdhjetë).**

Dokumentat për të vërtetuar këtë kriter janë:

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplome ose deshmi kualifikimi
- Kontrata pune
  - c) *Vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve te Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te rrethit perkates ose me vule elektronike .*
  - d) *Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 25)*

**Shënim: Argumentimi i nr. te punonjeseve behet vetem me qellim per justifikimin e stafit te kerkuar. Ndarja sipas specialiteteve ne kete rubrike te mos merret ne konsiderate ne plotesimin e kriterëve te percaktuara.**

*Shënim:* Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Ne raste kur makinerit disponohen me qera, këta punonjes mund te jene te kontraktuar nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë, si pasojë nuk mund të jenë domosdoshmërisht në listpagesën e shoqërisë.

**2.3.6.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
----	--------------------	----------	--------	-------

1	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qera	Copë	1
2	Kamion me vinc	në pronësi ose me qera	Copë	1
3	Fadromë	në pronësi ose me qera	Copë	1
4	Kamiocine me kapacitet mbajtës $\geq 3.5$ ton	në pronësi ose me qera	Copë	1
5	Autobetoniere	në pronësi ose me qera	Copë	1
6	Autobot uji	në pronësi ose me qera	Copë	1
7	Pompe betoni (pres betoni)	në pronësi ose me qera	Copë	1
8	Skeleri	në pronësi ose me qera	M2	200
9	Tabela sinjalistike	në pronësi ose me qera	Copë	10
10	Komplet i ndihmes se shpejt	Ne pronesi ose me qera	Copë	6
11	Prozhektor ndricimi naten	Ne pronesi ose me qera	Copë	6
12	Vibrator betoni	Ne pronesi ose me qera	Copë	1

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qira, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatat e pronësisë,
- siguracionin e mjetit.
- kolaudimin,
- certifikatë transporti
- fotografi të mjetit të paraqitura. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit) .

Për mjetet dhe pajisjet të cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimi të mjetit.

*Pranohet marrja me qera e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata e qeramarrjes të jetë bërë para noterit, me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt.*

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (të vlefshme), të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në shtojcën 8 në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor gjate procesit te vleresimit te ofertave.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme në lidhje me stafin dhe mjetet e nevojshme për realizimin e kontratës janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar volumeve te punimeve, orëve të punës dhe kohëzgjatjes së punimeve sipas grafikut të punimeve. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Për realizimin e mureve betonarme janë kërkuar mjetet si: Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, Eskavator, Autobetoniere, pompe betoni, skeleri, vibrator betoni, Fadrome, Eskavator me goma.

Për realizimin e mureve me gabiona janë kërkuar mjetet si: Kamioncine me kapacitet mbajtës mbi 3.5 ton, Kamion me vinc

Për realizimin e mureve të gurit janë kërkuar mjetet si: Eskavator me goma, Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Percaktimi i numrit të punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar mbi analizat e zerave të preventivit objekt prokurimi me qëllim realizimin me sukses të procedurës, sipas legjislacionit të fushës sipas analizës së mesipërme.

### **2.3.8. Certifikat ISO:**

- a) **ISO 9001-2015 – Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

#### **Argumentimi:**

Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte të cilësisë, e cila mundëson

implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- b) **ISO 14001 - 2015 - Standard për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

#### **Argumentimi:**

*Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria e cila punon/ushtron aktivitetin në një zonë prodhimi; e cila përfshin larminë e ajrit, tokës, ujit dhe burimeve natyrore, bimëve dhe kafshëve, dhe qeniet njerëzore dhe shoqërimin e tyre me njëri-tjetrin. Iso 14001 është standardi universal i procesit të monitorimit të përpjekjeve të një organizate drejt mjedisit të saj dhe në një kuptim tjetër të hapave përpara. Është një ndërveprim sistematik që lejon të zbatohet duke i kushtuar vëmendje efekteve rreth tij gjatë periudhës nga faza e parë e prodhimit deri te dorëzimi tek perdoruesit e këtij objekti, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.*

- c) **ISO 45001-2018 Standart për Menaxhimin e Shendetit dhe Sigurisë në Punë (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga

organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

### **Argumentimi:**

*Standarti ISO 45001-2018 është standarde ndërkombëtare, të cilët parashtrojnë kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. Të dy ofrojnë udhëzime që ju ndihmojnë të hartoni dhe ngrini strukturën e kompanisë suaj mbi sigurinë dhe shëndetin në punë – duke ju dhënë mundësinë të sillni të gjithë kontrollin e duhur dhe proceset në një sistem menaxhimi. Përfitimet Standarti ISO 45001-2018 Menaxhimi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë janë krijimi i kushtet më të mira të punës në gjitha ndermarjet dhe shoqëritë, identifikojnë kërcënimet dhe vendosin kontrollin për menaxhimin e tyre, reduktojnë aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot dhe kohën joproduktive të puntoreve, përfshijnë dhe motivojnë stafin me kushte më të mira dhe më të sigurt punë, dëshmojnë përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve të tyre.*

*Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundeson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe në Kodin të punës, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Ligjin nr.10237 datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM nr. 562, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”, VKM nr. 563, datë 03.07.2013 "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, VKM nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier si dhe në mbështetje të natyrës së objektit të prokurimit.

**Të gjitha materialet e përshkruara në preventiv duhet të jenë sipas specifikimeve teknike. Në rast se në një nga zërat e preventivit është shkruar me emra marke automatikisht do të pranohet edhe një produkt ekuivalent.**

Specifikimet teknike u hartuan nga **DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT** duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **18/06/2024, ora 11:00**.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: **“Ndërtim mure mbajtëse në qytet dhe rrethina”**,

**Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

Dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT: